



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:283658
Datë: 31.01.2024
Numri i dokumentit: 05267052

KA.nr.10/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Elektroprivreda Srbije Beograd” SH.A. me seli në Beograd, rr. “Carice Milice” nr.2, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson J. K., avokate nga Mitrovica dhe B. N., kundër të paditurit Agjencia e Regjistrimi të Bizneseve në Kosovë, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A. A. nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të Letër distribuimi me nr.prot. 599 i datës 02.05.2017, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 23.01.2024 në prezencë të përfaqësuesve të paditësit dhe të paditurit, me datë 31.01.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Elektroprivreda Srbije Beograd” SH.A., me të cilën ka kërkuar që të anulohet Letër distribuimi me nr.prot. 599 i datës 02.05.2017 i nxjerr nga i padituri Agjencia e Regjistrimi të Bizneseve në Kosovë dhe që gjykata të vendos në mënyrë meritore për regjistrimin e kompanisë “Elektrosever” Sh.p.k. me seli në Mitrovica e Veriut.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi “Elektroprivreda Srbije Beograd” SH.A., ka iniciuar konfliktin administrativ ndaj të paditurit Agjencia e Regjistrimi të Bizneseve në Kosovë (ARBK) me kërkesën për anulimin e Vendimit Nr.599 të datës 02.05.2017 i nxjerr nga i padituri Agjencia e Regjistrimi të Bizneseve në Kosovë (ARBK). Sipas padisë paditësi thekson se më 26.04.2017 kishte ushtruar kërkesë për regjistrimin e kompanisë energjetike “ESP Elektrosever”, mirëpo kjo kërkesë ishte refuzuar nga i padituri pa arsyetim adekuat të gjendjes juridike të arsyetimit. Tutje, ka shtuar se çdo vendim i sjell nga organi kompetent duhet të përcillet me arsyetim të gjerë, me arsyet juridike të argumentuara në rastin e refuzimit apo hedhjes së kërkesës, me udhëzimet mbi ndryshimet e nevojshme gjegjëse apo plotësimet e kërkesave mbi gjendjen faktike dhe me dëshmi. Më tej ka

theksuar se në rastin konkret, vendimit të kontestuar i ka munguar arsyetimi, për më tepër ngrit edhe çështjen e diskriminimit sa i përket të drejtës për përdorimin e gjuhës ku thekson se si gjuhë zyrtare në procedurë administrative kishte zgjedhur gjuhën serbe mirëpo, aktet e kontestuara i kishte pranuar në gjuhën shqipe. Gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se Shoqëria “Elektrosever” është regjistruar me propozim të Shefit të Grupit të Dialogut Avni Arifi, mirëpo ka shtuar se paditësi ka interes juridik që kjo çështje të zgjidhet edhe në bazë të ligjit, meqenëse e njëjta është zgjidhur në mënyrë politike dhe jo edhe në bazë të ligjit, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit dhe vlerësimit të provave të anuloj Vendimin (letrën e distribuimit) Nr. 599 të datës 02.05.2017 dhe atë të vendos me juridiksion të plotë dhe sipas ligjit ta regjistroj shoqërinë “Elektrosever” DOO apo SH.P.K me seli në Mitrovicën e Veriut.

I padituri përmes përfaqësuesit të autorizuar më 20.10.2023 ka parashtruar përgjigje në padi përmes të cilës ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit pasi që sipas të paditurit padia e paditësit është ushtruar jashtë afatit ligjor dhe me asnjë provë nuk ka argumentuar se ka plotësuar aplikacionin sipas rregullave të ARBK-së dhe Marrëveshjes së Brukselit, duke vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga administrimi i provave vërtetohet se aplikacioni i paditësit është refuzuar për shkak të mos përputhjes me ligjet e Republikës së Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit për Energji e për të cilat paditësi është njoftuar përmes Njoftimit të datës 03.11.2017. Gjykatës i ka propozuar që padia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Kërkesë për rishqyrtimin e vendimit nr. 599 të datës 02.05.2017, e parashtruar me datë 10.05.2017; Formular për aplikim për regjistrim të biznesit “Elektrosever” D.O.O i dorëzuar me datë 26.04.2017; Statuti i Shoqërisë “Elektrosever” DOO i datës 10.04.2017; Deklaratë e datës 12.04.2017; Kopje e letërnjoftimit e Boban Novakovic; Autorizim për Dragolub Simonovic i datës 05.06.2017; Listë distribuimi me nr.prot. 599 i datës 02.05.2017; Njoftim me nr.prot. 1456 i datës 03.11.2017 i nxjerr nga Kryeshefi Ekzekutiv i ARBK-së; Kopje e pasaportës për Milan Vujakovic; Kopje e letërnjoftimit për Miodrag Vicentievic; Certifikata e regjistrimit të biznesit për shoqërinë publike “Elektroprivreda”; Ankesë e datës 05.06.2017 ndaj Informimit nr. 599; Të dhënat nga ARBK lidhur me Shoqërinë “Drustvo Elektrosever” e regjistruar me datë 06.11.2018; Letër udhëzim për regjistrimin e dy kompanive të reja konform Marrëveshjes së Brukselit për Energji me Nr.Ref.154 i datës 09.09.2015; Certifikata për regjistrimin e subjektit ekonomik për shoqërinë aksionare “Elektroprivreda” Serbia, Beograd

me emër tregtar EPS JSC; Komunikim elektronik mes A. A. dhe E. Sh. i datës 07.11.2018 dhe palët tjera të përfshira; Certifikata për regjistrimin të biznesit “Drustvo Elektroserver” dhe informatat e biznesit; Komunikim elektronik mes Avni Arifi dhe Selim Selimi i datës 07.11.2018 dhe palët tjera të përfshira.

Gjykata, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, pretendimeve të përfaqësueses së paditësit në seancë, thënieve në padi dhe përgjigje në padi si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata konstatoi se paditësi më 26.04.2017 kishte parashtruar kërkesë për regjistrimin e kompanisë energjetike “ESP Elektroserver” tek i padituri ARBK.

I padituri lidhur me kërkesën e paditësit kishte nxjerr Letër distribuimi nr. prot. 599 të datës 02.05.2017 me të cilin kishte refuzuar regjistrimin e kompanisë sipas kërkesës së paditësit me arsyetimin se statuti i kompanisë në pjesën hyrëse nuk ka referimin e Marrëveshjes së Brukselit për Energji dhe Ligjit për Shoqëri Tregtare të Kosovës si dhe nuk është përmendur qyteti në të cilin gjendet selia e kompanisë por vetëm shteti, po ashtu në këtë akt administrativ thuhet se nuk ka vendim të EPS për themelimin e kompanisë, e cila gjithashtu do të duhej t’i referohet Marrëveshjes së Brukselit për Energji dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kosovës.

Ndaj këtij akti, paditësi më 10.05.2017 kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtim të aktit nr.599 (Letër distribuimi) të datës 02.05.2017 duke kërkuar anulimin e vendimit dhe mundësimin e regjistrimit të kompanisë energjetike “ESP Elektroserver”.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 17 par. 3 të Ligjit Nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare i cili përcakton se: *“17.3. Pala e pa kënaqur me vendimin e Kryeshefit të ARBK-së në afatin prej tetë (8) ditësh ushtron ankesë në Komisionin për parashtrësia dhe ankesa. Kundër vendimit të Komisionit për Parashtrësia dhe Ankesa pala e pa kënaqur në afatin prej tridhjetë (30) ditësh mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës.”* dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”*

Gjykata i vlerësoi si të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat nuk janë në përputhje me provat e administruara në këtë çështje dhe dispozitat ligjore të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së aktit kontestues.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga Formulari për aplikim për regjistrim të biznesit “Elektrosever” D.O.O i dorëzuar me datë 26.04.2017, gjykata konstaton se paditësi kishte aplikuar për regjistrimin e kompanisë energjetike “ESP Elektrosever”.

Nga Statuti i Shoqërisë “Elektrosever” Sh.p.k., i datës 10.04.2017, gjykata konstatoi se paditësi ka përpiluar Statutin për themelimin e Shoqërisë “Elektrosever” Sh.p.k. i datës 10.04.2017, me seli në Mitrovicë e Veriut, me aksionar të vetëm ndërmarrja publike “Elektroprivreda Srbije” dhe drejtor Boban Novakovic.

Nga Certifikata për regjistrimin të biznesit “Drustvo Elektrosever” Sh.p.k. dhe informatat e biznesit, e regjistruar me datë 07.11.2018, gjykata ka konstatuar se i padituri ka bërë regjistrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara “Drustvo Elektrosever” me numër të biznesit 810171900, me seli në rr. “Filipa Visnjic”, Mitrovicë Veriore, Republika e Kosovës, sipas datës së themelimit 26.04.2017, me aktivitetet primar nr. 3514 Tregtia e energjisë elektrike dhe aktivitet sekondar nr. 3314 Riparimi i pajisjeve elektrike, me aksionar të vetëm JP Elektroprivreda Srbija Beograd dhe me drejtor Boban Novakovic.

Letër udhëzim për regjistrimin e dy kompanive të reja konform Marrëveshjes së Brukselit për Energji me Nr.Ref.154 i datës 09.09.2015, gjykata konstaton se përmes kësaj letre informuese Ministria e Dialogut Edita Tahiri ka njoftuar zyrtarë të lartë shtetërorë përfshirë edhe Kryeshefin e ARBK që të bëhet regjistrimi i dy kompanive të reja “Elektrosever” dhe “Trgovina” konform Marrëveshjes së Brukselit për Energjinë.

Komunikim elektronik mes A. A. dhe E. Sh. i datës 07.11.2018 dhe palët tjera të përfshira, gjykata ka konstatuar se personat përgjegjës për dialog me Serbinë dhe zbatimin e marrëveshjes së energjisë kanë trajtuar çështjen e regjistrimit të biznesit të paditësit pranë ARBK. Gjykata po ashtu ka konstatuar se S. S. në cilësinë e Këshilltarit ligjor të Kryeministrit të Kosovës ka kërkuar nga personat përgjegjës që regjistrimi i biznesit të ri duhet të bëhet duke bashkërenduar tërësinë e dokumenteve të dorëzuara nga pala deri më tani me qëllim të kompletimit të një

aplikacioni të pranueshëm nga ARBK i cili do të jetë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktit të kontestuar në përputhje me nenin 3 të Ligjit 02/L-28 për Procedurën Administrative (LPA), i cili përcakton se: *“3.1. Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca.”*, si dhe nenit 11 të këtij ligji i cili parasheh obligimin për të vendosur për kërkesat e palëve: *“Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridikë.”*

Gjykata duke iu referuar nenit 38 të LKA –së i cili përcakton se: *“1. Në konfliktet administrative gjykata vendos në seancë të hapur. 2. Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve.”*, ka caktuar seancën përgatitore dhe të shqyrtimit kryesor. Gjatë këtyre seancave përfaqësuesi i të paditurit ka dorëzuar si provë Letër udhëzim për regjistrimin e dy kompanive të reja konform Marrëveshjes së Brukselit për Energji me Nr.Ref.154 e datës 09.09.2015 dhe komunikimin elektronik të datës 07.11.2018, përmes të cilës gjykata konstatoi se Ministria e Dialogut E. T. kishte njoftuar zyrtarë të lartë shtetërorë përfshirë edhe Kryeshëfin e ARBK që të bëhet regjistrimi i dy kompanive të reja “Elektrosever” dhe “Trgovina” konform Marrëveshjes së Brukselit për Energjinë dhe pastaj nga komunikimi i datës 07.11.2018 ishte kërkuar që të bëhet regjistrimi i shoqërisë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe ligjet tjera të aplikueshme, si dhe provën Certifikata për regjistrimin të biznesit “Drustvo Elektrosever” dhe informatat e biznesit nga e cila gjykata konstatoi se i padituri ka bërë regjistrimin e shoqërisë “Drustvo Elektrosever” sipas aplikimit të paditësit të datës 26.04.2017 dhe mbanë numrin unik identifikues 810171900, me aksionar të vetëm JP Elektroprivreda Srbije Beograd dhe përfaqësues ligjor Boban Novakovic.

Lidhur me këtë, gjykata ka vlerësuar pretendimet e paditësit se kompania “Elektrosever” është regjistruar me propozim të Shefit të grupit të dialogut A. A., mbi bazën e Marrëveshjes së Brukselit dhe se paditësi kërkon që çështja e regjistrimit të zgjidhet edhe në bazë të ligjit, meqenëse konsideron se zgjidhja e bërë është politike, por gjykata këto pretendime të paditësit i vlerësoi si të pabazuar pasi që nevoja për regjistrimin e biznesit ka ardhur si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit për Energji, ndërsa pas aplikimit, procedurat pranë të paditurit janë zhvilluar në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë, çfarë ka rezultuar me regjistrimin e shoqërisë “Drustvo Elektrosever” D.O.O. e që paraqitet si kërkesë edhe në komunikimin

elektronik të datës 07.11.2018 që regjistrimi i shoqërisë tregtare të bëhet në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Gjykata vlerëson se i padituri ka vepruar në kuptim të nenit 33 të Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare kur ka regjistruar shoqërinë “Drustvo Elektrosever” Sh.p.k. dhe se baza e funksionimit dhe rregullimit të çdo shoqërie tregtare është Ligji për Shoqëritë Tregtare.

Andaj, sipas vlerësimit të gjykatës regjistrimi i kompanisë energjetike “Drustvo Elektrosever” Sh.p.k., nga paditësi në vitin 2018 është bërë si rezultat i Marrëveshjen e Brukselit për Energji dhe bazuar në rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare në fuqi në kohën e regjistrimit të shoqërisë tregtare, andaj në këtë çështje të konfliktit administrativ gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit për ta regjistruar kompaninë edhe një herë është e pabazuar, pasi që paditësi një të drejtë të tillë veç se e ka realizuar përmes regjistrimit të kompanisë në vitin 2018.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve në procedurën mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për vendosjen ndryshe në këtë çështje të konfliktit administrativ.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.10/22, datë 31.01.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.